

ABU SEMAN  
Nr. 1706/1190  
dt 20/10/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT  
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 15 Datë 25/10/2018

**Per dhenien e lejes te perdorimit të burimit ujore te perroit te Voskopojes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nga subjektit "F&F" sh.p.k në Bashkia Korce qarku Korce.**

Në mbështetje te ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" i ndryshuar me ligjin nr 6/2018 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit te Ministrave "Per miratimin e kushteve te pergjithshme e te posacme, dokumentave shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formularve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore". Vendimit te Keshillit Kombetar te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore"

Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

**Miratimin e lejes te perdorimit të burimit ujore te perroit te Voskopojes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nga subjektit "F&F" sh.p.k në Bashkia Korce qarku Korce.**

**Perroit te Voskolojes dege e perroit Nishanit dege e lumit Devoll**

**HEC NISHANI**

**Vepra e marjes n1**

Kordinatat e vepres se marrjes janë :

X 4502386 Y 4461763 Z=948 m.n.d

Prurja mesatare Qmes = 1.122 m3/sek

Prurja llogaritese Qllog = 2.34 m3/sek

Prurja ekologjike Qeko = 0.1 m3/sek

**Goda e hec-it**

Kordinatat e godines se HEC janë :

X 4503499 Y 4460046 Z=822 m m.n.d

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do te jete rreth 2300 kW

Per perdorimin e ketij burimi uJOR duhet te plotesohen kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.

Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGRËGJËSI ABU SEMAN

Isuf Myrtaj



KRYETARI I KBU SEMAN

Baki BALA

